



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Zyra e Kryeministrit- Kancelarija Premijera-Office of the Prime Minister**  
**Sekretari i Përgjithshëm-Generalni Sekretar- Secretary General**

---

Në mbështetje të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, përkatësisht Nenit 31 pika 8 të shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 13.03.2008, si dhe bazuar në vendimin e Qeverisë 05/13 i datës 12 shkurt 2015 për emërimin e panelit të posaçëm (ad hoc) për identifikimin dhe rekomandimin e kandidatëve për anëtar të Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA), Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit Ri-shpall:

**K O N K U R S**

**Për Anëtar të Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike**

**I. Inspektor i Operimeve**

**II. Inspektor i Inxhinierisë**

**I. Inspektor i Operimeve**

***Kualifikimet e nevojshme:***

- ✓ Diploma e fakultetit në inxhinieri/ose Licencë piloti.

***Kualifikimet e dëshirueshme:***

- a) Posedues i licencës së pilotit të transportuesit të linjave ajrore apo certifikatës komerciale të pilotit me certifikatë mjekësore të klasës së parë;
- b) Njohuri në fushën e aviacionit;
- c) Njohuri të mira mbi mekanikën, komunikimet dhe/ose sistemet elektronike të aeroplanëve që përdoren për shërbimet e navigimit ajror;
- d) Njohuri mbi menaxhimin e projekteve.

**II. Inspektor i Inxhinierisë**

***Kualifikimet e nevojshme:***

- ✓ Diploma e fakultetit në inxhinieri.

***Kualifikimet e dëshirueshme:***

- a.) Posedues i licencës së pilotit të linjave ajrore komerciale apo private me certifikatë mjekësore të klasës së parë apo të dytë;
- b.) Njohuri në fushën e aviacionit;
- c.) Njohuri mbi mekanikën dhe/ose sistemet elektronike të aeroplanëve që përdoren për shërbimet e navigimit ajror;
- d.) Njohuri mbi menaxhimin e projekteve.

### ***Kualifikimet e përgjithshme për pozitat e lartshënuara***

Neni 31, paragrafi 31, pika 7, e Ligjit mbi Aviacionin Civil ka përcaktuar kualifikimet minimale vijuese për inspektorët e KHAIA:

- Te ketë njohuri te konsiderueshme te gjuhës angleze
- Të ketë përvojë te konsiderueshme teknike në industrinë e aviacionit,
- Të mos jete shpallur fajtor për vepër penale,
- Të mos ketë interes direkt apo indirekt monetar, financiar apo ndonjë interes tjetër në çfarëdo organizate afariste e cila është e angazhuar në sektorin e aviacionit civil, dhe
- Të jetë person me moral të lartë dhe integritet profesional.

### **INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT**

Kandidatët për postin anëtarit të KHAIA duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- CV-në
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës dhe kërkesa tjera të parapara me ligjin për aviacionin civil)
- Certifikatë (dëshminë) që s'është nën hetime.

Kandidatët të cilët emërohen anëtar të KHAIA, do ti përmbahen nenit 31.9 te Ligjit për Aviacionin Civil.

Paga parashihet sipas Buxhetit të Kosovës.

Dokumentacionet duhet të jenë në pliko (zarf) të mbyllur dhe të dorëzohen në Divizionin e Personelit të Zyrës së Kryeministrit, Ndërtesa e Qeverisë, kati I, zyra nr. 105.

Për informata shitesë mund të njoftoheni përmes telefonit 038 200 14 400.

Kërkesat që dorëzohen pasi të mbyllet afati i konkursit nuk do të pranohen.

Do të kontaktohen vetëm kandidatet e përzgjedhur për listën e ngushtë.

Afati i konkursit është i hapur 15 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor (nga data 17.04.2015 deri më datë 04.05.2015).